



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 101/11 Prot.

Tiranë më 17.03.2020

URDHËR

Nr. 37 Datë 17.03.2020

PËR PEZULLIMIN E AFATIT TË APLIKIMEVE PËR FINANCIM ME GRANTE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 769 datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (I Ndryshuar); në vijim të Vendimit Nr. 1 datë 12.03.2020 dhe në aktet juridike shtetërore mbi përcaktimin e masave mbrojtëse ndaj përhapjes së Virusit COVID- 19 (*Coronavirus*):

URDHËROJ:

- I. Pezullimin e Afatit të Aplikimit nga Subjektet e Shoqërisë Civile në funksion të asistencës financiare nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile prej datës 17.03.2020 deri në një njoftim të dytë;
- II. Aplikimet e marra përgjatë këtij afati pezullues në rrugë postare, (sipas udhëzimit të Planit të Masave Organizativo- Administrativ mbi Ofrimin e Shërbimeve nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile do të shqyrtohen me mbarimin e afatit të pezullimit;
- III. Ngarkohet:
  - Zyra e Sekretarisë për protokollimin e këtij Urdhri;
  - Specialisti i Informimit dhe Publikimit për njoftimin e këtij Urdhri Subjekteve të Shoqërisë Civile;

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

  
DREJTORI EKZEKUTIV  
Andi KANANAJ